



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTOR EKZEKUTIV

Nr. 313/prot.
3

Tiranë, më 8. 4. 2024

VENDIM

Nr. 30 Datë 8. 4. 2024

PËR PEZULLIMIN E LICENCËS SË OPERIMIT SHOQËRISË AJRORE
ALBAWINGS SH.P.K

Bazuar në pikën 2/c, neni 21 të Ligjit Nr.96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 53/2022 “ Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, pikës 5, neni 10 të Vendimit nr. 802, datë 28.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kërkesave për dhënien e licencës së operimit për ofrimin e shërbimeve ajrore, procedurat, kriteret dhe kushtet për refuzimin, pezullimin apo revokimin e licencës së operimit”, si dhe të shkresës Nr.907/1, datë 05.04.2024 të AAC-së me lëndë “Vendim për ngritje të gjetjes së nivelit të parë dhe pezullimin e Certifikatës së Operatorit Ajror për shoqërinë ajrore Albawwngs sh.p.k”,

VENDOSA:

1. Pezullimin e Licencës së Operimit të operatorit ajror shqiptar Albawings sh.p.k Nr.04, datë 26.01.2024 për shkak të pezullimit të Certifikatës së Operatorit Ajror së tij.
2. Njoftimin e operatorit ajror Albawings sh.p.k

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et' hemaj

